VENDIM
Nr. 217, Datë 20.12.2019

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ELVA 2001 SHA NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "MIVAS", ME KAPACITET TË INSTALUAR 1940 kW

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2, germa" a", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, të nenit 4, pika 1, germa "a", të nenit 5, pika 1, germa "a" dhe nenit 13, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 15, të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019 mbasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga shoqëria "Elva 2001" sh.p.k., si dhe pasi shqyrtoi relacionin nr. 115/4 prot., datë 12.12.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Elva 2001" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie, nga HEC "Mivas", me kapacitet të instaluar 1940 kW,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 151, datë 14.10.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë "Elva 2001" sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Mivas", me kapacitet të instaluar 1940 kW.
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje u krye njoftimi në median e shkruar, me shkresën nr. 32/42, datë 15.10.2019, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria "Elva 2001" sh.a.
- ERE, me shkresën nr. 656 prot., datë 21.10.2019, iu drejtua shoqërisë "Elva 2001" sh.a. duke i njoftuar vendimin për fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar, i cili konsistonte në:
- neni 9, pika 2, germa "g" (dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti);
- neni 9, pika 3, germa "c" (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit);
- neni 9, pika 4.1.1 (të dhëna teknike për HEC-in, pika 3, pika 8, pika 11, pika 16, pika 19);
- neni 9, pika 4.1.4, germa e (dokumentacioni tekniko-ekonomik).
- Shoqëria "Elva 2001" sh.a, me shkresën e protokolluar në ERE, nr. 656/1 prot., datë 4.11.2019, ka përcjellë në ERE dokumentacionin e kërkuar.
- Duke konstatuar se nuk ishin shteruar të gjitha kërkesat për dokumentacionin e munguar, ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 656/2 prot., datë 12.11.2019 për plotësimin e informacionit dhe dokumentacionit të munguar.
- Shoqëria "Elva 2001" sh.a, me shkresën protokolluar në ERE me numër 656/3, datë 20.11.2019, ka përcjellë në ERE dokumentacionin e kërkuar.
- Shoqëria "Elva 2001" sh.a., është një subjekt tregtar i krijuar me vendimin nr. 25441, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, datë 15.3.2001, në zbatim të ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991 dhe mban numër identifikimi (NUIS) K12809402J.
- Shoqëria "Elva 2001" sh.a. është mbajtëse e "Miratimit përfundimtar për ndërtimin e objektit, hidrocentralit 'Mivas', me kapacitet prodhues 1940 kW, në pellgun ujëmbledhës të lumit të Tomorricës, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan, me nr. 2657/2 prot., datë 27.12.2017", mbështetur në

pikën 2, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si dhe në VKM-në nr. 822, datë 7.10.2015, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", të ndryshuar.

- Shoqëria ka nënshkruar kontratën me nr. 5 rep., nr. 3/3 kol., datë 25.01.2018 me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Kohëzgjatja e kontratës do të jetë 49 vjet, me të drejtë ripërsëritje. Referuar kësaj kontrate, për afatet e vënies në punë të veprës, mbajtësi i miratimit merr përsipër të vë në punë hidrocentralin brenda 21 (njëzet e një) muajve nga data e marrjes së të gjitha lejeve për fillimin e punimeve, siç është parashikuar në grafikun e punimeve të paraqitur në aneksin 2, bashkëlidhur kontratës.

- Afati i aplikimit, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga strukturat shtetërore, për pajisjen me lejet e nevojshme, është jo më shumë se 12 muaj nga data e hyrjes në fuqi të kontratës. Rezulton se shoqëria ka vijuar me aplikimet për pajisjen me lejet në institucionet përkatëse.

- Periudha e vlefshmërisë së lejes së shfrytëzimit të ujit është deri në datën 16.11.2022.

- Shoqëria bën me dije se i ka të gjitha mundësitë për të vënë në punë HEC-in brenda vitit 2019.

- Aplikimi i shoqërisë "Elva 2001" sh.a, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" si më poshtë:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat: "a", "b" dhe "c") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: "a", "b", "c", "d", "e", "f" dhe "g") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat: "a", "b", "c" dhe "d") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.1.1, pika 4.1.2, pika 4.1.3, germat: "a", "b", "c", "d"; pika 4.1.4 germat: "a", "b", "c", "d", "e"; pika 4.1.5, germat: "a", "b", "c") është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Në kuptim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, ERE përcakton kushtet që duhet të përmbushen për marrjen e çdo licence, duke marrë në konsideratë, ndër të tjera: a) afatin e vlefshmërisë së licencës, i cili për veprimtaritë e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes nuk mund të jetë më shumë se 30 vjet;

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë 'Elva 2001' sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC 'Mivas', me kapacitet të instaluar 1940 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria "Elva 2001" sh.a. duhet të depozitojë në ERE: a) kontratën e rinovuar të qirasë me Bashkinë Gramsh, brenda datës 25.3.2029, ose certifikatën e lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), që rregullon të drejtën e përdorimet të pronës në zonë ku shtrihet centrali i prodhimit të energjisë elektrike; b) kontratën e rinovuar të qirasë me Bashkinë Skrapar, brenda datës 16.7.2026, ose certifikatën e lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), që rregullon të drejtën e përdorimet të pronës në zonë, ku shtrihet centrali i prodhimit të energjisë elektrike.

3. Shoqëria "Elva 2001" sh.a. duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC "Mivas", brenda datës 5.10.2028.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti